



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 23

Prishtinë, më 05. 10. 2010, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Fatmir Rexhepi – kryetar, Danush Ademi, Ibrahim Makolli, Hajredin Hyseni, Nerxhivane Dauti, Luljeta Shehu, Shpresa Murati, Ibrahim Selmanaj dhe Drita Maliqi.

Pjesëmarrës të tjerë: ElitaVokshi dhe Lejla Selimi OSBE, Isuf Zejna – KDI, Jetmir Bakija-NDI, dhe Juxhina Brouch-PDK.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj - koordinator dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e drejtoi: Fatmir Rexhepi - kryetar.

Fatmir Rexhepi konstatoi se në bazë të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës ishin plotësuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 27. 09. 2010,
3. Shqyrtimi i amendamenteve të dhëna në Projektligjin për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës, nga aspekti i të drejtave të njeriut,
4. Shqyrtimi i amendamenteve të dhëna në Projektligjin për rregullatorin e energjisë, nga aspekti i të drejtave të njeriut,
5. Shqyrtimi i amendamenteve të dhëna në Projektligjin për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosove, nga aspekti i të drejtave të njeriut,
6. Shqyrtimi i amendamenteve të dhëna në Projektligjin për energjinë, nga aspekti i të drejtave të njeriut,

7. Shqyrtimi i amendamenteve të dhëna në Projektligjin për mbrojtjen e konkurrencës , nga aspekti i të drejtave të njeriut,
8. Shqyrtimi i amendamenteve të dhëna në Projektligjin për energjinë elektrike , nga aspekti i të drejtave të njeriut,
9. Shqyrtimi i disa peticioneve,
10. Të ndryshme.

Miratimi i rendit të ditës

U propozua që të shtohet si pikë e rendit të ditës shqyrtimi i propozim amendamenteve në Projektligjin për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe të banesave

Rendi i ditës u miratua me këtë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 27. 09. 2010

Komisioni e miratoi pa vërejte procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 27.09.2010.

Kryetari - ne fillim i përshëndeti mysafiret dhe anëtarët e Komisionit dhe i njoftoj me projektligjet të cilave duhet të jepet mendim nga aspekti i të drejtave të njeriut dhe si vijon:

Komisioni konstatoi se amendamentet e Projektligjit për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës, (3) Amendamenteve të dhëna në Projektligjin për rregullatorin e energjisë, (4) nga aspekti i të drejtave të njeriut amendamentet e të dhëna në Projektligjin për themelimin e sistemit për sigurimin e depozitave për institucionet financiare në Kosovë (5), nga aspekti i të drejtave të njeriut, amendamentet e dhëna në Projektligjin për energjinë, (6) nga aspekti i të drejtave të njeriut, amendamentet e dhëna në Projektligjin për mbrojtjen e konkurrencës (7) , nga aspekti i të drejtave të njeriut, janë në pajtueshmëri me Konventën Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Deklaratën Universale për të drejtat e njeriut, Konventën për eliminimin të gjitha formave të diskriminimit dhe nuk i cenojnë parimet e përgjithshme dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, prandaj mund të procedohen për miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

8 Shqyrtimi i amendamenteve të dhëna në Projektligjin për energjinë elektrike, nga aspekti i të drejtave të njeriut

Ibrahim Makolli- i beri vërejtjet në amendamentin 35 që ka të bëjë me nenin 39 paragrafi 7.1 lidhur me veprat penale që kanë të bëjnë me energjinë elektrike, këtu edhe cenohen të drejtat e njeriut edhe është në kundërshtim me Kodin Penal të Kosovës, dhe shtoi se Komisionit që të rishqyrtoj edhe një herë këtë amendament, *Komisioni e mbështeti propozimin e parafolësit dhe njëzëri vendosi ta nxjerrë këtë*

Përfundim

Komisioni kërkon nga Zyra ligjore te kontaktoj me Zyrën ligjore të Komisionit funksional lidhur me harmonizimin e nenit 39 të Projektligjit me Kodin Penal të Kosovës para se të procedohet në seancë plenare.

Komisioni konstatoi se amendamentet e dhëna në Projektligjin për energjinë elektrike, të Komisionit Funksional, përveç nenit 39 paragrafit 7.1, nuk i cenojnë parimet e përgjithshme dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

9 Shqyrtimi i amendamenteve të dhëna në Projektligjin për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe të banesave,

Ibrahim Makolli- pati vërejtje në amendamentin 10, lidhur me përdorimin e gjuhëve zyrtare, dhe tha se Komisioni për Legjislacion është duke harmonizuar tekstin. Ai tha se regjistrimi ndodh një herë në 10 vite dhe duhet me paraparë formular në gjuhën e pakicave pavarësisht se a i plotëson kriteret me 5 përqindëshin, prandaj thëkë në disa komuna që me ligjin lokal e plotëson këtë kriter po në disa komuna të tjera jo, e perse ata që janë në numër të pakët mos me realizua këtë të drejtë me pas formularin në gjuhën e vet.

Danush Ademi- e përkrahi mendimin e parafolësit dhe shtoi : ai që e plotëson formularin duhet me njohtë gjuhën për ta plotësuar atë formular prandaj Komisioni konstatoi se amendamentet e Projektligjit për regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe të banesave, të komisionit funksional për Administratë Publike, Pushtet Lokal dhe Media, janë në pajtueshmëri me Konventën Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, Deklaratën Universale për të drejtat e njeriut, Konventën për eliminimin të gjitha formave të diskriminimit dhe nuk i cenojnë parimet e përgjithshme dhe standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, prandaj mund të procedohen për miratim në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

10 Shqyrtimi i disa peticioneve,

Nerxhivane Dauti - Në cilësi të raportueses tha se i ka shqyrtuar kërkesën e shoqatës së personave me aftësi të kufizuara të UP-së, dhe peticionin e Rrahim Dajakut nga Rakinica e Skenderajt për ndriçimin e masacrës së Tivarit, për të cilat Komisionit i ofroi zgjidhje. Komisioni e mbështeti mendimin e saj lidhur me ofrimin e zgjidhjes vendosi të njoftohen palët me rekomandimet përkatëse.

Ibrahim Makolli- duke u ndërlidhur me peticionin nënvizoi se i obligojnë institucionet publike që të krijojnë kushte për personat me aftësi të kufizuara dhe kërkuar nga Rektorati dhe Ministria e Arsimit dhe t’iu krijojnë kushte për personat me aftësi të kufizuara të kenë qasje sa më të lehtë në këto institucione, prandaj moszbatimi i ligjeve shkakton shkelje të të drejtave të njeriut.

Drita Maliqi- kërkojë Ministrisë së Arsimit dhe Rektorati i Universitetit t’ua rregullojë infrastrukturën në objektet ekzistuese, sigurimi i stazave dhe tha se nuk duhet investim i

madh i mjeteve financiare,prandaj propozoi që Komisioni qe t'i rekomandojë ministrisë së Arsimit dhe Rektoratit që të plotësohen sa më parë këto kushte.

Hajredin Hyseni- pajtua që t'i kërkohet Ministrisë së Arsimit dhe Rektoratit por apelojë që të zbatohet ligjet dhe të krijohen kushtet për këta persona,pasi ligjet n ë fuq iu sigurojnë kushte .

Ishte konstatim i përgjithshëm qe komisioni t'i kërkojë Rektoratit dhe Ministrisë së Arsimit që me urgjencë të ndërmerren masat për krijimin e kushteve që ju nevojiten për rregullim e kushteve të këtyre personave në pajtim me ligjin.

11 Të ndryshme

Kryetari i njoftoi me rrjedhën e mbajtjes se tryezës rrumbullak qe do të mbahet me 12.10.2010 ne Retoranin Rigns me temën “Debat lidhur me projektligjin për personat e pagjetur “ Komisioni u njoftua me punët rreth organizimit te tryezës

Mbledhja përfundoi në orën 14:00

Kryetari i Komisionit

Fatmir Rexhepi